



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:300417

Datë: 20.10.2020

Numri i dokumentit: 01211687

C.nr.1644/19

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Alban Beqiri, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësve B.H. nga fshati Komuna Ferizaj, F.Z. nga fshati komuna Ferizaj, A.M. Shtimja, I.J. nga fshatiKomuna Ferizaj dhe V.T. nga fshati Komuna Lipjan të cilët me autorizim i përfaqëson av Arian Hetemi nga Lipjan, kundër të paditurës Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë Prishtinë, në çështjen juridike, shpërblimit jubilar, kompenzimi në emër të udhëtimit dhe ushqimit, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 14.10.2020, mori, kurse me datën 20.10.2020, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësve B.H. nga fshati Komuna Ferizaj, F.Z. nga fshati Komuna Ferizaj, A.M. nga Shtimja, I.J. nga fshatiKomuna Ferizaj dhe V.T. nga fshati Komuna Lipjan si e bazuar.

II. DETYROHET e paditura, që paditësve secilit veç e veç në emër të pagës jubilarë, shpenzimet e udhëtimit dhe ushqimit t'ua paguaj shumat dhe atë

- Paditësit B.H. në emër të ushqimit shumën prej 1,502.00€, kurse në emër të shpenzimeve të udhëtimit shumën prej 525.70€, për ditët e pranisë në punë prej datës 17.04.2017 deri me datën 31.07.2020, në kohëzgjatje prej 751 ditë, kurse për shpërblim jubilar 75% e një page bazë shumën prej 452.86€, apo gjithsejtë shumën prej 2.480.56€ (dy mijë e katërqind e tetëdhjete euro e pesëdhjete e gjashtë cent).

- Paditësit F.Z. në emër të ushqimit shumën prej 1.364€, kurse në emër të shpenzimeve të udhëtimit shumën prej 477.40€, për ditët e pranisë në punë prej datës 17.04.2017 deri me datën 08.06.2020, në kohëzgjatje prej 682 ditë kurse për shpërblim jubilar 50% e një page bazë

shumën prej 248.45€, apo gjithsejtë shumën prej 2.089.85€ (dy mijë e tetëdhjetë e nëntë euro e tetëdhjetë e pese cent).

- Padiësja A.M. në emër të ushqimit shumën prej 1.364€, kurse në emër të shpenzimeve të udhëtimit shumën prej 668.36€, për ditët e pranisë në punë prej datës 17.04.2017 deri me datën 08.06.2020, në kohëzgjatje prej 682 ditë €, apo gjithsejtë shumën prej 2.032.36€ (dy mijë e tridhjetë e dy euro e tridhjetë e gjashtë cent).

- Padiësi I.J. në emër të ushqimit shumën prej 1.364€, kurse në emër të shpenzimeve të udhëtimit shumën prej 286.44€, për ditët e pranisë në punë prej datës 17.04.2017 deri me datën 29.06.2020, në kohëzgjatje prej 682 ditë kurse për shpërblim jubilar 50% e një page bazë shumën prej 245.51€, apo gjithsejtë shumën prej 2.089.85€ (dy mijë e tetëdhjetë e nëntë euro e tetëdhjetë e pese cent).

- Padiësja V.T. në emër të ushqimit shumën prej 1.296€, kurse në emër të shpenzimeve të udhëtimit shumën prej 907.20€, për ditët e pranisë në punë prej datës 17.04.2017 deri me datën 08.06.2020, në kohëzgjatje prej 648 ditë €, apo gjithsejtë shumën prej 2.203.20€ (dy mijë e dyqind e tre euro e njëzet cent).

III DETYROHET e paditura që shumat e përcaktuara sikurse në pikën II të dispozitivit tua paguaj padiësve secilit veç e veç me kamat ligjore prej 8% nga data 14.10.2020, deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 817.60€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

IV DETYROHEN padiësit që të paguajnë solidarisht diferencën e taksës gjyqësore për padi në shumë prej 80€

A r s y e t i m

Padiësit përmes të autorizuarit të tyre kanë deklaruar se mbetësin edhe me tutje pranë padisë, parashtrësës për precizimin e kërkesëpadisë të dorëzuar me shkrim, si dhe deklarimeve nga seancat e kaluar duke shtuar se nga provat e administruara është vërtetuar sikurse baza juridike e kërkesëpadisë ashtu dhe lartësia e saj sa i përket bazës juridike e njëjta është vërtetuar me anë të Kontratës Kolektive të Arsimit e datës 17.04.2017, e nënshkruar në mes të paditurës në

njërën anë dhe SBASHKU në anën tjetër ku përmes të cilës kontratë është përcaktuar qartë se kush përfiton nga kjo kontratë në rastin konkretë paditësit u takon komepnzimi i në emër të pagës jubilarë, shujtës dhe udhëtimit.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë për secilin paditësi është vërtetuar përmes provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës e të cilat nuk kanë qenë kontestuese nga ana e të paditurës siç është përvoja e punës, vërtetimet për ditët e pranisë në punë dhe çmimorja e biletës së udhëtimit

Andaj ka kërkuar nga ana e gjykatës që ta aprovon në tërësi kërkesëpadinë e paditësve të precizuar me parashtresë për secilin veç e veç si të bazuar të gjitha me kamat ligjore prej 8% si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Përfaqësuesja i të paditurës ka deklaruar se mbesim edhe më tutje pranë përgjigjes në padi, deklarimeve nga seancat e kaluar duke e kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar si nga baza ashtu edhe nga lartësia, pasi që me dispozitat ligjore nga neni 46 par 2 i kontratës kolektive të arsimit thekson se MASHT dhe SBASHK angazhohen bashkërisht me Ministrinë e Financave për sigurimin ndarjen e mjeteve financiare për komunat e Kosovës me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm të përcaktuar në nenin 35 par 5,7 dhe 9, brenda mundësive institucionale, ligjore, dhe financiare, që nënkupton se këto mundësi financiare nuk janë krijuar andaj dhe e paditura nuk ka detyrim ndaj paditësve, paditësi si anëtarë i sindikatës apo vetë SBASHKU nuk kanë bërë asnjë angazhim të vetëm apo shkresë drejtuar Ministrisë së Financave për sigurimin e mjeteve brenda mundësive financiare , andaj konstatojmë se për realizimin e kësaj të drejte nuk ekzistojnë mundësit institucionale-financiare.

Duke kërkuar nga ana e gjykatës që të merr aktvendim me të cilën ta hudhë poshtë padinë si të palejuar për shkak të mos shterjes se mjeteve juridike të brendshme, nëse gjykata vlerëson të kundërtën atëherë të merr aktgjykim me të cilën e refuzon në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar, njëherit e ka kontestuar edhe kamatën ligjore.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve ka bërë administrimin e provave si vijojnë: U lexua kontrata e punës e lidhur në mes të paditurës dhe paditësës V.T. dt.29.09.2015 nr 652/3, kontrata e punës e lidhur në mes të paditurës dhe paditësit I.J. dt.29.09.2015 nr 633/3it F.Z., dt.29.09.2015 nr 633/3, kontrata e punës e lidhur në mes të paditurës dhe paditësit F.Z. dt.29.09.2015 nr 634/3, kontrata e punës e lidhur në mes të

paditurës dhe paditëses A.M. dt.04.02,2019 nr 24/3, akt emërimi lëshuar nga e paditura në emër të paditësit B.H. dt.19.05.2017 nr. 133/1, autorizimet e paditësve B.H., V.T., I.J. , F.Z. dhe A.M. dhënë avokatit Arjan Hetemi, vërtetimet lëshuar nga e paditura në emër të paditësit B.H., V.T., I.J., F.Z., A.M. me nr. Protokolli 84 /19 dt.17.12.2019, vendimi i të paditurës dt.12.05.2017 nr 130/1 në emër të paditësit B.H., listat e pages në emër të paditëses A.M., I.J., B.H., V.T. dhe F.Z., kuponi fiskal lëshuar nga N.T.T “.....” dt.17.12.2019, kuponi fiskal lëshuar nga ”.....” i SHPK dt.14.12.2019, certifikata e vendbanimit dt.13.12.2019, lëshuar në emër të paditëses A.M., certifikata e vendbanimit dt.17.12.2019 në emër të paditësit F.Z., vërtetimi lëshuar nga e paditura për ditët e pranisë në punë në emër të paditësit B.H., vërtetimi lëshuar nga e paditura për ditët e pranisë në punë në emër të paditësit F.Z., vërtetimi lëshuar nga e paditura për ditët e pranisë në punë në emër të paditësit A.M., vërtetimi lëshuar nga e paditura për ditët e pranisë në punë në emër të paditësit I.J., vërtetimi lëshuar nga e paditura për ditët e pranisë në punë në emër të paditësit V.T., autorizimi i të paditurës dhënë përfaqësuesit M.K., çmimorja lëshuar nga SHPK dt.21.05.2020, parashresa e paditësit dt.30.06.2020, në të cilën ia ka bashkangjitur provat materiale – kupinat fiske për paditësit B.H., A.M., I.J. dhe V.T., autorizimi i të paditurës dhënë përfaqësueses F.G., vërtetimet mbi ditët e pranisë në punë lëshuar në emër të paditësve B.H., F.Z., I.J. , V.T. dhe A.M., të bashkangjitur në precizimin e kërkesëpadisë.

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre veç e veç si dhe të ndërlidhura në tërësi mes veti, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk ishte kontestuese në mesë palëve ndërgjygjëse se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe nga data 18.04.2017 kur dhe ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive deri me datën 31.07.2020, kanë qenë në vendin e punës, respektivisht është vërtetuar prezenca e tyre në vendin e punës në ditët e precizuara për secilin paditës veç e veç, por kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë se a u takojnë paditësve shumat e kërkuara.

Gjykata përmes kontratave të punës të cilat janë administruara ka vërtetuar faktin se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura.

Gjykata me leximin e vërtetimeve për ditët e pranisë në punë dhe përvojën e punës të paditësve lëshuar nga Qendra e Kompetencës –Ferizaj secilin paditës veç e veç ka vërtetuar faktin për

ditët e pranisë të paditësve në vendin e punës nga data 17.04.2017, kur ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive deri me datën 31.07.2020, dhe atë paditësi B.H. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 751 ditë, paditësi F.Z. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës për 682 ditë , paditësja A.M. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës për 682 ditë , paditësi I.J. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës për 682 ditë , paditësja V.T. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës për 648 ditë.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me Kontratën Kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 49 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësit e kanë shfrytëzuar një të drejtë pasi që të njëjtit përfitojnë nga kjo kontratë për faktin se për periudhën nga data 17.04.2017 deri me datën 31.07.2020, kanë qenë në vendin e punës respektivisht prezenca e tyre në vendin e punës i cili fakt është vërtetuar përmes vërtetimit për ditët e pranisë në punë të lëshuar Qendra e Kompetencës Ferizaj, andaj sipas nenit 35 par.7 është paraparë që të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë, për një ditë pune është 2 euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, andaj gjykata sa i përket aprovimit të lartësisë kërkesëpadisë në lidhje me ushqimin paditësve e ka bazuar duke e llogaritur ditët e pranisë në punë të secilit paditës veç e veç e duke e shumëzuar me 2 euro, sa është e përcaktuar me Kontratën Kolektiv të Arsimit.

Sa i përket kërkesëpadisë të paditësve për kompenzimin e dëmit në emër të shpenzimeve të udhëtimit, gjykata e ka bazuar duke u nisur nga provat të cilat janë administruara përmes të cilave është vërtetuar se paditësi B.H. është me adresë në fshatin Komuna Ferizaj dhe për të ardhur në vendin e punës në Ferizaj nga vendbanimi i tij, çmimi i biletës një drejtim është 0.50 cent, respektivisht dy drejtime 1 euro, e cila nuk ka qenë kontestuese për të paditurën, e duke marr parasysh ditët e pranisë në punë 751 ditë në njërën anë kurse në anën tjetër lartësinë e përcaktuar me kontratën kolektive të kompenzimit të 70% të çmimit të biletës rezulton që shuma që i është njohur paditësit është në lartësi prej 525.70€, paditësi F.Z. është me adresë në fshatin, Komuna Ferizaj dhe për të ardhur në vendin e punës në Ferizaj nga vendbanimi i tij, çmimi i biletës një drejtim është 0.50 cent, respektivisht dy drejtime 1

euro, e cila nuk ka qenë kontestuese për të paditurën, e duke marr parasysh ditët e pranisë në punë 682 ditë në njërën anë kurse në anën tjetër lartësinë e përcaktuar me kontratën kolektive të kompensimit të 70% të çmimit të biletës rezulton që shuma që i është njohur paditësit është në lartësi prej 477.40€, paditësja A.M. është me adresë në fshatin Komuna Shtime dhe për të ardhur në vendin e punës në Ferizaj nga vendbanimi i tij, çmimi i biletës një drejtim është 0.70 cent, respektivisht dy drejtime 1.40 euro, e cila nuk ka qenë kontestuese për të paditurën, e duke marr parasysh ditët e pranisë në punë 682 ditë në njërën anë kurse në anën tjetër lartësinë e përcaktuar me kontratën kolektive të kompensimit të 70% të çmimit të biletës rezulton që shuma që i është njohur paditësit është në lartësi prej 668.36€, paditësi I.J. është me adresë në fshatinKomuna dhe për të ardhur në vendin e punës në Ferizaj nga vendbanimi i tij, çmimi i biletës një drejtim është 0.30 cent, respektivisht dy drejtime 0.60 cent, e cila nuk ka qenë kontestuese për të paditurën, e duke marr parasysh ditët e pranisë në punë 682 ditë në njërën anë kurse në anën tjetër lartësinë e përcaktuar me kontratën kolektive të kompensimit të 70% të çmimit të biletës rezulton që shuma që i është njohur paditësit është në lartësi prej 286.44€, paditësja V.T. është me adresë në fshatin e Epërme Komuna Lipjan dhe për të ardhur në vendin e punës në Ferizaj nga vendbanimi i tij, çmimi i biletës një drejtim është 1€, respektivisht dy drejtime 2€, e cila nuk ka qenë kontestuese për të paditurën, e duke marr parasysh ditët e pranisë në punë 648 ditë në njërën anë kurse në anën tjetër lartësinë e përcaktuar me kontratën kolektive të kompensimit të 70% të çmimit të biletës rezulton që shuma që i është njohur paditësit është në lartësi prej 907.20€.

Andaj duke u nisur nga dispozitat ligjore të lart cekura të Kontratës Kolektive, si dhe gjendjes faktike, rezulton që kërkesëpadia e paditësve është e bazuar ku dhe e ka detyruar të paditurën që paditësve secilit veç e veç tua paguaj shumat e specifikuara në pikën II të dispozitivit pasi që nga provat e administruara është vërtetuar fakti se paditësit dhe atë paditësi B.H. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 751 ditë, paditësi F.Z. për këtë periudhë ka qenë ne vendin e punës për 682 ditë , paditësja A.M. për këtë periudhë ka qenë ne vendin e punës për 682 ditë , paditësi I.J. për këtë periudhë ka qenë ne vendin e punës për 682ditë , paditësja V.T. për këtë periudhë ka qenë ne vendin e punës për 648 ditë, në njërën anë kurse në anën tjetër e paditura nuk e ka përmbushur obligimin siç e ka pasur për detyrim sipas Kontratës Kolektive e datës 18.04.2017, sa i përket mjeteve monetare për ushqim dhe nenit 8 të LMD-së, ku thuhet se “Pjesëmarrësi në marrëdhënie të detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”, e të cilin detyrim e paditura nuk e ka përmbushur ndaj paditësve me arsyetim se nuk ka mjete financiare për këtë kategori.

Sa i përket pagës jubilarë gjykata është bazuar në nenin 35 par.8 pika 8.1 dhe 8.2 të Kontratës Kolektive duke u bazuar në listën e përvojës së punës rezulton që paditësi B.H. ka përvojë pune 22 vite, e cila nuk ka qenë kontestues për të paditurën e që sipas kësaj kontrate për 22 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të 75% e një page bazë, e që duke marr parasysh që paga e paditësit është 603.82€, siç vërtetohet përmes listë së pagës i bije që në emër të pagës jubilarë paditësit takon shuma prej 452.86€, paditësit F.Z. ka 16 vite përvojë pune, e cila nuk ka qenë kontestues e që sipas kësaj kontrate për 16 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë 50% e një page bazë, e që duke marr parasysh që paga e paditësit është 496.90€, siç vërtetohet përmes listë së pagës i bije që në emër të pagës jubilarë paditësit takon shuma prej 248.45€, paditësit I.J. , ka përvojë pune mbi 13 vite, e cila nuk ka qenë kontestues për të paditurën e që sipas kësaj kontrate për 13 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë 50% një page bazë, e që duke marr parasysh që paga e paditësit është 491.03€, siç vërtetohet përmes listë së pagës i bije që në emër të pagës jubilarë paditësit takon shuma prej 245.51€.

Sa i përket pretendimit të përfaqësuesit të paditurës se kërkesëpapia e paditësve duhet të refuzohet për faktin se e paditura nuk ka mjete financiare që ti përmbushë këto detyrime ndaj paditësve, këto pretendime për gjykatën janë të pa bazuara për faktin se me nenin 2 të kësaj kontrate të gjitha DKA e institucioneve të arsimit të lart, n; rastin konkretë shkollat speciale në rastin konkret e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë kontratë kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin me kohë për këto raste, e jo të thirret se nuk ka mjete të destinuara për këto raste respektivisht nuk ka vij buxhetore andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek paditësit, kurse sa i përket pretendimit se SBASHKU në bashkëpunim me MASHT ti sigurojnë mjetet financiare tek Ministria e Financave për çka nuk kanë nëprë përpjekje fare SBASHKU gjykata konsideron se një përgjegjësi e tillë është e të paditurës sigurimin e mjeteve financiare duhet ti siguroj e paditura.

Kurse sa i përket pretendimit se paditësi nuk kanë orar të plotës të punës dhe nuk u takon kompensimi në ushqim, gjykata konspiron se një pretendim i tillë është i pa bazuar pasi që paditësit e kanë primare marrëdhënien e punës tek e paditura, andaj nuk mund të lidhet me orët e procesit mësimor.

Kurse sa i përket pretendimit se paditësit fillimisht është dashur ti shtjerrin mjetet e brendshme juridike e pastaj të paraqesin padi në gjykatë gjykata konsideron se një pretendim i tillë është i

pa bazuar pasi që e paditura ka pasur detyrim ligjor tua paguaj paditësve shujtën ditore, shpenzimet e udhëtimit dhe pagat jubilarë pa paraqitur fare kërkesë në procedurë administrative, pasi që kemi të bëjmë me të ardhura personale andaj gjykata nuk ka gjetur bazë të padinë e paditësve ta hudhë poshtë ashtu siç e ka kërkuar e paditura.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata duke u bazuar në nenin 452 par 1 të LPK-së e ka obliguar të paditurën që paditësve t'ua paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 817.60€ dhe atë për përpilim të padisë shumë prej 312€, për taksën gjyqësore për padi 100€, dhe për përfaqësim të avokatit në një seancë 405.60€, për shkak se kemi të bëjmë me mbi 5 paditës si dhe vlera e kontestit është mbi 10.000€, pjesa tjetër refuzohet si e pa bazuar, pasi që nuk janë krijuar me fajin e të paditurës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.1644/19 date 20.10.2020

Gjyqtari
Alban Beqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.